



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:107364

Datë: 05.07.2022

Numri i dokumentit: 03200925

CPK.nr.102/22
P.nr.359/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesionale Faton Lakna, duke vendosur në procedurën përbarimore të kreditorit SSh nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S avokat nga Gjilani, kundër debitorit KGj – QMF në Gjilan, lidhur me prapësimin e debitorit të datës 06.05.2022, jashtë seancës më 05.07.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i datës 06.05.2022, i paraqitur nga debitori K Gj, kundër Urdhërit Përbarimor të Përbaruesit KMM për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 357/2022, të datës 28.04.2022.

II. SHFUQIZOHET Urdhëri Përbarimor i Përbaruesit Privat KMM, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 359/2022, të datës 28.04.2022.

A r s y e t i m i

Përbaruesi Privat KMM për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, ka lejuar përbarimin e propozuar të kreditorit SSh, kundër debitorit KGj, me të cilin propozim kreditori ka kërkuar lejimin e përbarimit në bazë të dokumentit përbarimor-aktvendimit C.nr.2405/2020, të dt.26.01.2022, i plotfuqishëm më dt.09.02.2022 dhe i ekzekutueshëm më dt.18.02.2022, që debitori, t'ia paguaj kreditorit shumën e të hollave prej 134.00 €, në afat prej 7 ditësh, në emër të përmbushjës së detyrimit të papaguar sipas pikës III të dispozitivit të të njejtit aktvendim, lidhur me shpenzimet e peocedurës kontestimore, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, pas pranimit të Urdhërit për Përbarim në afatin ligjor më dt.06.05.2022, ka ushtruar prapësim, ku e ka kundërshtuar lejimin e urdhërit përbarimorë, duke theksuar se propozimit për përbarim i mungon baza ligjore për faktin se konform dospozitave të LPP-së, kompetenc

për zbatimin e përmbarimit të aktgjykimeve të kësaj natyre e që lidhen me marëdhënien e punës është Gjykata Themelore – Zyra Përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në këtë rast propozimi për përmbarim nuk ka bazë juridike të mjaftueshme të cekur si më lartë, i njejtë ka kërkuar nga gjykata që të nxjerrë aktvendim me të cilin do të aprovohet prapësimi i debitorit KGj në tërësi si i bazuar në ligj, dhe të anulohen të gjitha veprimet në lidhje me përmbarimin sipas urdherit përmbarimor P.nr.359/22, të dt.28.04.2022, në mungesë të bazës juridike.

Kreditori në përgjigjëjen në prapsim të dt.12.05.2022, ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit të paraqitura në prapësimi si të pa bazuara në ligj duke theksuar pretendimi i debitorit se propozimit për përmbarim i mungon baza ligjore nga fakti se për zbatimin e përmbarimit për aktgjykimet e kësaj natyre kompetente është gjykata e jo përmbaruesi privat, ky pretendim nuk qëndron për faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me qështje nga mardhënia e punës, pasi që në propozim për përmbarim kemi kërkuar vetëm shpenzimet e procedurës kontestimore, të cilat shpenzime janë krijuar me fajin e të paditurës tani debitorit, andaj shuma e kërkuar në propozim për përmbarim nuk lidhet me kryegjenë apo shpërblimin jubilar në rastin konkret por vetëm me shpenzimet e procedurës e cila qështje nuk bën pjesë në domenin e qështjeve nga marëdhënia e punës, andaj i njejtë i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve, ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar në ligj, dhe urdhëri për përmbarim P.nr.356/22 i dt.28.04.2022, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve të dhëna në prapsimin dhe në përgjigjëje në prapsim erdhi në përfundimin se prapësimi i debitorit i dt.06.05.2022, është i bazuar dhe i njejtë duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktvendimi, nga se duke u bazuar në dispozitën e nenit 5 par.6 nën par.6.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore “: gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera”, ku për të njejtën dispozitë Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Udhëzuesin Gj.A-Su.A.36/2021, të dt.05.02.2021, për kompetencën e organit përmbarimor lidhur me vendosjen në procedurën e përmbarimit dhe lidhur me zbatimin e përmbarimit për qështjet nga e drejta familjare, kthimin e punëtorëve në punë dhe kompenzime tjera, ku ka theksuar se organ kompetent përmbarimor për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe për të zbatuar përmbarimin në kontestet lidhur me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë; dhe kompenzimet tjera përfshirë (pagat, pagat jubilarë, pagat përcjellëse në pension, shujtat dhe bonuset tjera), është gjykata, pa parrë parasysh se vendimin përmbarimor (dokumentin përmbarimor), e ka nxjerrë gjykata apo ndonjë institucion, rrespektivisht organ tjetër, andaj duke u bazuar në arsyet e lartëcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lartë e në pajtim me nenin 5,22,71,72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në pikën **I** dhe **II**, të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:107364
Datë: 05.07.2022
Numri i dokumentit: 03200925

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:107364, 05.07.2022

Gjyqtari
Berat Spahiu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan.